

**Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm për Misionin e  
Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara  
në Kosovë**

**I. Hyrje**

1. Ky raport dorëzohet në pajtim me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, përmes së cilës Këshilli themeloi Misionin e Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) dhe i kërkoi Sekretarit të Përgjithshëm që të raportoj në intervale të rregullta për zbatimin e mandatit të tij. Raporti mbulon aktivitetet e UNMIK-ut dhe zhvillimet lidhur me to nga data 16 mars 2022 deri më 15 shtator 2022.

2. Prioritetet e Misionit mbesin avancimi i sigurisë, stabilitetit dhe i respektimit të të drejtave të njeriut në Kosovë dhe në regjion. Me qëllim të plotësimit të këtyre objektivave, UNMIK-u vazhdon angazhimin e tij konstruktiv me Prishtinën dhe Beogradin, me të gjitha komunitetet në Kosovë dhe me palët regjionale e ato ndërkombëtare. Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Kosovë (OSBE) dhe Forca e Kosovës (KFOR) vazhdojnë me zbatimin e roleve të tyre brenda kornizës së Rezolutës [1244 \(1999\)](#). Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit vazhdon praninë e tij në Kosovë në përputhje me deklaratën e kryetarit të Këshillit të Sigurimit, të datës 26 nëntor 2008 ([S/PRST/2008/44](#)) dhe me raportin e Sekretarit të Përgjithshëm, të datës 24 nëntor 2008 ([S/2008/692](#)). Agjencitë, fondet dhe programet e Kombeve të Bashkuara kanë bashkëpunim të ngushtë me Misionin.

## II. Zhvillimet kryesore politike dhe të sigurisë

3. Retorika më e zëshme mes Beogradit dhe Prishtinës dhe përshkallëzimi i tensioneve në terren kanë ndikuar negativisht në përparimin e normalizimit të marrëdhënieve gjatë periudhës raportuese. Mospajtimet mes palëve u përqendruan në votimet për zgjedhjet e Serbisë në Kosovë, në çështjet e lirisë së lëvizjes dhe në zbatimin e marrëveshjeve të mëhershme për energji dhe për asociacionin/bashkësinë e komunave me shumicë serbe. Përkrahja e vazhdueshme e zyrtarëve të Bashkimit Evropian dhe palëve të tjera ndërkombëtare me interes kanë ndihmuar në shtensionimin dhe ruajtjen e angazhimit në dialogun e ndërmjetësuar nga BE-ja.

4. Beogradi dhe Prishtina kanë përparuar rreth disa çështjeve konkrete në dialogun e ndërmjetësuar nga BE-ja. Më 21 qershor, palët miratuan një udhërrëfyes për zbatim të marrëveshjeve për energjinë të viteve 2013 dhe 2015. Në këtë udhërrëfyes saktësohen hapat dhe afatet që duhet të realizohen nga secila palë brenda një periudhe 100 ditëshe. Këtu parashihet integrimi i katër komunave të veriut me shumicë serbe në sistemin energjetik të Kosovës. Beogradi dhe Prishtina u pajtuan që si hap të parë Zyra e Rregullatorit të Energjisë e Kosovës t'ia lëshoj licencën për furnizim Elektroserverit, degë kjo e kompanisë shtetërore energjetike të Serbisë. Më pastaj do të nënshkruheshin marrëveshjet teknike mes Elektroserverit dhe Operatorit të Kosovës për Transmision, Sistem dhe Treg (KOSTT), dhe Shërbimit të Kosovës për Shpërndarjen e Energjisë (KEDS). Brenda këtyre marrëveshjeve Elektroserver do të bënte shpërndarjen në katër komunat veriore me shumicë serbe, ndërsa KOSTT-it dhe KEDS-it do t'i mundësohej qasja në infrastrukturën e transmisionit dhe shpërndarjes në Kosovën e veriut.

5. Momentumi fillestar për zbatimin e udhërrëfyesit të energjisë që nga ajo kohë ka ngecur. Më 24 qershor, Zyra e Rregullatorit të Energjisë e Kosovës ia dha licencën për furnizim Elektroserverit. Megjithatë, zbatimi i hapave të mëtejshme, duke përfshirë përmbylljen e marrëveshjeve teknike, ende nuk është bërë.

6. Ecja përpara në zbatimin e udhërrëfyesit gjithashtu është ndikuar edhe nga tensionet e ngritura për çështjet e tjera. Këtu përfshihen vendimet e Qeverisë së Kosovës të datës 29 qershor për lëshimin reciprok të deklaratave të përkohshme hyrje-dalëse për poseduesit e dokumenteve të identitetit të Serbisë dhe zëvendësimi i obligueshëm i targave të automjeteve të lëshuara nga Serbia me shkurtesa të lokaliteteve të Kosovës me targa të lëshuara nga Kosova mes datës 1 gusht dhe 30 shtator 2022. Sipas Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës, automjetet që nuk janë të regjistruara në sistemin e Kosovës deri në afatin e fundit, do të konsiderohen të paligjshme dhe nuk do të lejohen të qarkullojnë brenda Kosovës.

7. Përfaqësuesit e serbëve të Kosovës dhe Beogradi i shpallen këto vendime si veprime të njëanshme në kundërshtim me marrëveshjet e ndërmjetësuar nga BE-ja. Më 31 korrik, një ditë para fillimit të zbatimit të vendimeve, në komunat e veriut janë lëshuar sirenat për paralajmërim të sulmit nga ajri dhe janë ngritur postblloqet në rrugët që qojnë drejt kufirit administrativ në Jarinjë (porta 1) dhe Bërnjak (porta 31). Më pas, policia e

Kosovës i mbylli këto vendkalime. Policia e Kosovës raportoi disa të shtëna të drejtuara kah njësitë e saj dhe një eksplozim, por pa lëndime. Policia po ashtu raportoi disa incidente të protestuesve që kishin keqtrajtuar dhe lënduar banorët shqiptarë, si dhe dëmtimin e automjeteve të tyre. Një zhvillim shqetësues është se një numër domethënës i individëve të armatosur mirë janë vërejtur në mesin e protestuesve serbë. Thashethemet dhe dezinformatat kanë përshkallëzuar më tej retorikën dhe shqetësimin e qytetarëve. Përfaqësuesja Speciale e Sekretarit të Përgjithshëm për Kosovë, Caroline Ziakeh, ka apeluar për qetësi, rikthimin e lirisë së lëvizjes dhe angazhimin me vullnet të mirë në kuadër të dialogut të ndërmjetësuar nga BE-ja. KFOR-i ka bërë thirrje të ngjashme dhe ka shprehur gatishmërinë e tij për të ndërhyrë për të siguruar mjedis të qetë dhe të sigurt. Komandanti i KFOR-it u takua me përfaqësuesit e serbëve të Kosovës dhe ka mbajtur kontakt të vazhdueshëm me zyrtarët në Beograd dhe Prishtinë.

8. Prishtina akuzoi Beogradin si përgjegjës për postblloqet dhe për mobilizimin e protestave në veri. Udhëheqësit serbë të Kosovës paralajmëruan qeverinë në Prishtinë se serbët e Kosovës në mënyrë të njëanshme do të themelojnë asociacionin/bashkësinë e komunave me shumicë serbe nëse nuk e kthen prapa vendimin e saj.

9. Pas angazhimit diplomatik të palëve ndërkombëtare në mbrëmjen e 31 korrikut, Prishtina u pajtua për të shtyrë zbatimin e masave të saj deri më 1 shtator dhe protestuesit më pas larguan postblloqet (më 27 gusht palët u pajtuan për mekanizimin e hyrje-daljes, siç përshkruhet në paragrafin 29). Megjithatë, incidentet sporadike të sigurisë vazhduan. Më 6 gusht, pati të shtëna drejt barkës patrulluese të policisë së Kosovës në liqenin e Gazivodës në komunën e Zubin Potokut (nuk është raportuar për lëndime). Policia e Kosovës, KFOR-i dhe Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit rriten praninë e tyre dhe patrullat në veri, duke përfshirë edhe përgjatë rrugëve që shpijnë kah porta 1 dhe 31. Muralet urrejtëse në disa vende në veri të Kosovës ngritën shqetësimet e qytetarëve.

10. Më 18 gusht, përfaqësuesi i lartë i Bashkimit Evropian për Punë të Jashtme dhe Politikë të Sigurisë dhe zëvendëspresidenti i Komisionit Evropian, Josep Borrell, priti në Bruksel presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq dhe kryeministrin, Albin Kurti. Përderisa nuk pati marrëveshje specifike për lirinë e lëvizjes, ata u zotuan për takime të rregullta dhe diskutuan elemente lidhur me normalizimin e marrëdhënieve.

11. Më 3 prill u mbajtën zgjedhjet presidenciale, parlamentare dhe ato të pjeshme komunale në Serbi. Organizimet për zgjedhje në Kosovë edhe kësaj radhe shkaktuan kundërthënie dhe tensione. Në përputhje me qëndrimin e saj për referendumin kushtetues të Serbisë të 16 janarit 2022, Prishtina kundërshtoi organizimin e votimit në Kosovë pa një kërkesë të drejtpërdrejtë zyrtare nga qeveria e Serbisë. Prishtina propozoi që votimi të organizohet përmes postës ose në hapësirat e zyrës ndërlidhëse të Beogradit në Prishtinë, gjë që është konsideruar si e papranueshme nga Beogradi. Përkundër përpjekjeve të shteteve të kuintit (Franca, Gjermania, Italia, Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës Veriore dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës) dhe Bashkimit Evropian për të lejuar votimin në bazë të praktikave më të mira, ku OSBE-ja do të grumbullonte fletëvotimet,

marrëveshja nuk është arritur. Në reagim të kësaj, më 25 mars Lista Serbe organizoi protestë paqësore në Graçanicë dhe në Mitrovicë të Veriut. Në ditën e zgjedhjeve qeveria e Serbisë organizoi transportimin e votuesve me të drejtë vote nga Kosova për në qendrat e votimit në Serbi qendrore pa ndonjë incident të madh. Diku rreth 19500 votues nga gjithsej 93000 votues me të drejtë vote nga Kosova hodhën votën e tyre në zgjedhjet e Serbisë.

12. Presidenti aktual, Aleksandar Vuçiq, siguroi mandatin e dytë, duke fituar 58 për qind të votave. Koalicioni udhëheqës, i udhëhequr nga Partia Progresiste e presidentit, fitoi rreth 43 për qind të votave, ndërsa blloku kryesor opozitar – koalicioni Të Bashkuar për Fitoren e Serbisë, fitoi 13.5 për qind, i pasuar nga partneri i koalicionit i Partisë Progresiste Serbe, Partia Socialiste e Serbisë.

13. Në kuadër të përpjekjeve të reja për anëtarësim në organizata ndërkombëtare, më 12 maj Kosova parashtroi kërkesën për anëtarësim në Këshillin e Evropës, gjë që çoi në protestë të Beogradit. Pas takimit të Këshillit Kombëtar për Siguri të Serbisë, të thirrur nga presidenti Vuçiq, ditën pasuese ku ai paralajmëroi për pasoja të rënda, ministri i Punëve të Jashtme i Serbisë, Nikolla Sellaković, deklaroi se si reagim ndaj aplikimit të Kosovës, ai i ka dorëzuar presidentit të Serbisë katër nota të tërheqjes së njohjes prej katër shteteve të paidentifikuara. Qeveria e Kosovës gjithashtu ka shprehur qëllimin e saj që deri në fund të vitit të parashtroj kërkesën për anëtarësim në Bashkimin Evropian, dhe për t'iu bashkuar Programit për Paqe të Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior.

14. Udhëheqësit e Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë u takuan brenda kornizës së nismës Ballkani i Hapur më 7 dhe 8 qershor në Ohër të Maqedonisë së Veriut dhe më 1 shtator në Beograd. Kryeministri i Malit të Zi, Dritan Abazović, dhe kryesuesi i Këshillit të Ministrave të Bosnje dhe Hercegovinës, Zoran Tegeltija, morën pjesë si vëzhgues. Udhëheqësit, në mes të tjerash, nënshkruan marrëveshjet për bashkëpunim në fushën e arsimit, kulturës, turizmit, energjisë dhe në atë të industrisë ushqimore. Qeveria e Kosovës vazhdoi me kundërshtimet e saj të kamotshme ndaj nismës, e cila, sipas pikëpamjes së saj, do të dëmtonte objektivat dhe vlerat e integriteteve evropiane përmes Procesit të Berlinit, posaçërisht krijimin e Tregut të përbashkët regjional. Kancelari gjerman, Olaf Scholz, përsëriti përkrahjen për Procesin e Berlinit gjatë vizitës së tij në Kosovë më 10 qershor. Ai premtoi përkushtimin e Gjermanisë për rivitalizimin e Procesit të Berlinit me qëllim të avancimit të integriteteve evropiane përmes lëvizjes së lirë të personave, mallrave, shërbimeve dhe kapitalit në regjion përgjatë vijave të nismës së Tregut të përbashkët regjional për Ballkanin Perëndimor.

15. Më 20 qershor, qeveria e Shqipërisë dhe ajo e Kosovës mbajtën në Prishtinë takimin e tyre të tetë të përbashkët, me ç'rast nënshkruan disa marrëveshje të bashkëpunimit, duke përfshirë atë për lirinë e lëvizjes, sigurinë dhe diversifikimin e furnizimit me energji, lidhjet hekurudhore, turizmin dhe bujqësinë.

16. Më 23 dhe 24 qershor, Këshilli i Evropës u takua në Bruksel në kuadër të presidencës franceze të Këshillit të Bashkimit Evropian, ku u rikonfirmua nevoja për përparim të dukshëm në dialogun mes Beogradit dhe Prishtinës.

Mungesa e çfarëdo reference lidhur me liberalizimin e vizave për Kosovën në konkludimet e takimit është përcjellë me shqetësim nga ana e Prishtinës. Më 3 gusht, Kuvendi i Kosovës miratoi rezolutën, ku ftohet Bashkimi Evropian që Kosovës t'ia jap liberalizimin e vizave.

17. Institucionet e Kosovës miratuan disa reforma të rëndësishme lidhur me zgjedhjet dhe partitë politike. Më 1 korrik, Kuvendi i Kosovës krijoi një komision ad-hoc për reformën zgjedhore. Komisioni do të përpiqet të trajtojë rekomandimet e Misionit vëzhgues të Bashkimit Evropian për zgjedhjet lidhur me fuqizimin e transparencës, llogaridhënies dhe pjesëmarrjes së grave në politikë. Në muajin gusht, Kuvendi miratoi projektligj për financimin e subjekteve politike dhe ratifikoi marrëveshjet për partneritetin e kornizës financiare në kuadër të instrumentit të Komisionit Evropian për Asistencë të Paraaderimit III. Në kuadër të kësaj marrëveshjeje ofrohen afro 64 milionë euro në vit, duke filluar nga viti 2021 deri më 2027 si përkrahje për sundimin e ligjit, si dhe për reformat në ekonomi, qeverisje dhe energji.

18. Më 14 qershor, Kuvendi i Kosovës miratoi në lexim të parë amandamentet e propozuara nga qeveria në Ligjin për pagën minimale. Kësaj date i paraprinë protestat e anëtarëve të Organizatës së Veteranëve të Luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës jashtë Kuvendit ku kërkuan, por pa sukses, përfshirjen e tyre si përfitues në legjislacion. Në fund të gushtit, federata e sindikatave të pavarura e Kosovës shpalli grevë të përgjithshme të të punësuarve në institucionet publike, ku kërkohet rritja e pagave deri në miratimin e ligjit për paga në sektorin publik.

19. Më 21 korrik, Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin për regjistrimin e popullsisë dhe të amvisërive në Kosovë. Data e regjistrimit të popullsisë ende nuk është shpallur, ku regjistrimi i fundit është bërë në vitin 2011. Fondi i Popullsisë i Kombeve të Bashkuara (UNFPA) është duke i dhënë ndihmesë teknike Agjencisë së Statistikës të Kosovës për përgatitjen e regjistrimit të popullsisë.

20. Nga data 16 mars deri më 31 gusht, janë regjistruar nëntë incidente ndaj vendeve fetare dhe varrezave ortodokse serbe në vendet me komunitet joshumicë. Si shembuj mund të merren incidentet e vjedhjes së rëndë në kishën ortodokse serbe në fshatin Zhivinjan të komunës së Prizrenit. Në qytetin e Prizrenit, keqbërësit dëmtuan portën dhe derën e kishës ortodokse serbe. Në një incident me shkrimin e grafitëve, shkronja “Z” është shkruar në një kishë ortodokse serbe në qytetin e Shtimës, ndërsa flamuri serb është hequr dhe më vonë djegur në qytetin e Vitisë.

21. Disa gurë të varrezave janë dëmtuar në varrezat ortodokse serbe në Pejë, ndërsa në dy raste raportohet se janë dëmtuar kryqet e drurit në varrezat e qytetit të Rahovecit. Vjedhjet kanë ndodhur në disa lokacione fetare të konfesioneve të ndryshme në vende të ndryshme të Kosovës, në vendet ku komuniteti i prekur jeton në shumicë, duke përfshirë kishat ortodokse serbe, xhamitë dhe varrezat myslimane.

22. Gjatë periudhës raportuese disa incidente të tjera të profilit të lartë shkaktuan tensione mes komuniteteve. Më 29 qershor, një mashkull qytetar i Serbisë është arrestuar në Gazimestan për nxitje të urrejtjes gjatë festës së

Shën Vidit. Më 6 shtator, Gjykata themelore në Prishtinë e dënoi atë me tetë muaj burg. Në fshatin Hoçë e Madhe të komunës së Rahovecit, gjatë muajve qershor dhe gusht janë raportuar plaçkitje të shitoreve me pronar serbë. Në gusht, janë shkruar grafitë ofendues në një shtëpi me pronar serb në fshatin Bërnice e Poshtme të komunës së Prishtinës. Në shtator, dy serbë, babë e bir, janë goditur me thikë në fshatin Babimoc të komunës së Obiliqit. Më pas policia e Kosovës kishte arrestuar dy shqiptarë si të dyshuar lidhur me këtë sulm. Incidentet e dhunës seksuale të drejtuar kah komunitetet rome, ashkallike dhe egjiptase gjithashtu paraqesin shqetësim të veçantë. Në qershor janë raportuar një numër kërcënimesh për vendosje të bombave në shkolla të administruara nga qeveria e Serbisë dhe në Aeroportin e Prishtinës, për të cilat Policia e Kosovës konfirmoi se ishin të rreme.

23. Më 6 gusht në kufirin administrativ në veri të Kosovës, Policia e Kosovës ndaloj një gazetare nga Federata Ruse, e cila raportohet se ka kërkuar të vizitojë kishat ortodokse serbe në Kosovë. Ajo u lirua pas disa orësh. Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës e shpalli atë “persona non grata” për shkak të angazhimit në spiunazh, duke ia ndaluar hyrjen në Kosovë për pesë vite. Ambasada e Federatës Ruse në Beograd e quajti ndalimin nga policia dhe ndalimin për hyrje në Kosovë si “provokim” dhe “mospërfillje” e parimeve demokratike bazë, duke përfshirë lirinë e lëvizjes”.

24. Më 21 korrik, Kuvendi i Shqipërisë miratoi rezolutën për “Pretendimet e pabaza lidhur me trafikimin e paligjshëm të organeve njerëzore në Kosovë dhe Shqipëri”, duke iu referuar krimeve të pretenduara të kryera nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës gjatë luftës në Kosovë. Rezoluta i referohet mungesës së perceptuar të provave të dala nga hetimet dhe aktakuza nga Prokurori i Specializuar i Kosovës në mbështetje të pretendimeve lidhur me trafikimin e organeve njerëzore. Përmes kësaj Rezolute ftohet Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës që të hartojë një raport që do të qonte në rishikimin e Rezolutës së saj 1782 (2011), e cila ka shërbyer si bazë për hetime.

### **III. Normalizimi i marrëdhënieve mes Beogradit dhe Prishtinës**

25. Gjatë periudhës raportuese, grupi punues në kuadër të dialogut mes Beogradit dhe Prishtinës të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian, që ka për detyrë identifikimin e zgjidhjes së përhershme për çështjen e targave të automjeteve, mbajti dy takime në Bruksel më datat 6 dhe 21 prill, por pa ndonjë marrëveshje.

26. Më 4 maj, Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian për dialogun mes Beogradit dhe Prishtinës dhe çështjet e tjera regjionale të Ballkanit Perëndimor, Miroslav Lajčák, u takua me kryeministrin Kurti dhe me presidentin Vuçiq në Berlin me ftesë të qeverisë së Gjermanisë. Presidenti Vuçiq dhe kryeministri Kurti gjithashtu mbajtën takime të ndara dypalëshe me kancelarin gjerman, Scholz, i cili theksoi rëndësinë e përparimit në dialog për një paqe dhe stabilitet të qëndrueshëm dhe integrimin evropian të të dyja palëve.

27. Më pas, më 13 maj në Bruksel z. Lajčák u takua ndaras me kryenegociatorët e të dyja palëve. Diskutimet nuk rezultuan me dalje nga qorrsokaku lidhur me targat e automjeteve, por një shkallë e caktuar përparimi është arritur për çështje të tjera, siç është energjia. (më 21 qershor, palët miratuan një udhërrëfyes për zbatim të marrëveshjeve për energji të viteve 2013 dhe 2015, ashtu siç përshkruhet në paragrafin 4).

28. z. Lajčák vizitoi Prishtinën dhe Beogradin nga datat 27 qershor deri më 2 korrik dhe përsëri nga datat 24 deri më 26 gusht, ku në vizitën e fundit ishte së bashku me të dërguarin e posaçëm të ShBA-së për Ballkanin Perëndimor dhe zëvendësndihmësin e Sekretarit të Shtetit, Gabriel Escobar. Sipas z. Lajčák, diskutimet u fokusuan në zbatimin e udhërrëfyesit për energji, çështjen e personave të zhdukur, bashkëpunimin regjional, takimin e mundshëm të nivelit të lartë mes Beogradit dhe Prishtinës dhe zgjidhjen e çështjeve të lirisë së lëvizjes.

29. Më 27 gusht, z. Borrell deklaroi se Beogradi ishte pajtuar për heqjen e

dokumenteve të hyrje-daljes për poseduesit e dokumenteve të identifikimit të Kosovës dhe që Prishtina nuk do t'i fus ato për poseduesit e dokumenteve të identifikimit të Serbisë, përderisa diskutimet për targat e automjeteve do të vazhdonin. Në kuadër të përpjekjeve të mëtejme për çuarjen përpara të dialogut, këshilltarët për politika të jashtme dhe të sigurisë të presidentit të Francës dhe të kancelarit të Gjermanisë, së bashku me z. Lajčák, vizituan Prishtinën dhe Beogradin më 9 shtator dhe u takuan me kryeministrin Kurti dhe presidentin Vuçiq.

#### **IV. Kosova veriore**

30. Situatën në Kosovën veriore e kanë shënuar tensionet dhe incidentet e sigurisë. Më 22 mars, përfaqësuesit e serbëve të Kosovës, duke përfshirë edhe punonjësit e drejtësisë dhe të policisë nga veriu i Kosovës, kanë marrë pjesë në mbledhjen e thirrur nga presidenti Vuçiq në Beograd, si përgjigje ndaj kundërshtimeve të Prishtinës që më 3 prill të mbahen në Kosovë votimet për zgjedhjet serbe. Këshilli Gjyqësor i Kosovës më vonë ka pezulluar kryetaren e Gjykatës themelore në Mitrovicë për pjesëmarrje në atë takim. Në shenjë proteste përfaqësuesit e Listës Serbe, gjyqtarët serbë dhe disa punonjës komunalë nuk janë paraqitur në punë, dhe punës ia kanë filluar më 10 maj, pas përfundimit të suspendimit të kryetare së Gjykatës themelore.



31. Në prill janë raportuar disa sulme ndaj policisë së Kosovës në komunën e Zubin Potokut dhe të Leposaviqit, të cilat rezultuan me dëmtim të automjeteve të policisë. Pasoja në njerëz nuk ka pasur. Palët ndërkombëtare, duke përfshirë Përfaqësuesen Speciale të Sekretarit të Përgjithshëm, kanë dënuar sulmet.

32. Më 23 qershor, disa ditë pas shpalljes së udhërrëfyesit zbatues për energji, në Mitrovicën e Veriut një mjet shpërthyes dëmtoi një kablo të voltazhit të lart dhe automjetet e kompanisë në objektin e kompanisë për shpërndarjen e energjisë të Serbisë, Elektrodistribucija Srbije, në Mitrovicë të Veriut.

33. Më 24 gusht, para vizitës së përbashkët të z. Lajčák dhe z. Escobar në veri të Kosovës, kuvendet komunale dhe kryetarët e katër komunave të veriut me shumicë serbe mbajtën një mbledhje të përbashkët në Zvečan. Aty miratuan një deklaratë, ku protestohej kundër masave “të njëanshme” të Prishtinës. Në deklaratë shpallej tërheqja e mundshme e përfaqësuesve të serbëve të Kosovës nga të gjitha institucionet e Kosovës, duke përfshirë policinë dhe gjyqësorin, në mungesë të një zgjidhjeje të pranueshme për lirinë e lëvizjes. Po ashtu, në këtë deklaratë kërkohet themelimi i asociacionit/bashkësisë së komunave me shumicë serbe. Gjatë takimit të tyre më vonë gjatë ditës me Përfaqësuesen Speciale, përfaqësuesit e serbëve të Kosovës gjithashtu theksuan mungesën e perceptuar të angazhimit të Prishtinës me komunitetin serb të Kosovës në veri. Përfaqësuesja Speciale inkurajoi zgjidhjen e këtyre çështjeve përmes dialogut dhe parandalimin e çfarëdo veprimi përshkallëzues.

34. Policia e Kosovës rriti praninë e saj në katër komunat e veriut të banuara me shumicë serbe, duke hapur stacione të reja policore në terren dhe duke sjellë policë shqiptarë nga pjesët e tjera të Kosovës. Operacionet e policisë shpesh janë bërë pa përfshirjen e policëve të stacioneve lokale policore, duke krijuar kështu fërkime mes shtabit të policisë së Kosovës në Prishtinë dhe komandës lokale të policisë, si dhe me popullatën vendore. Kjo mund të ketë ndikim negativ në integrimin e policisë në veri të Kosovës.

35. Më 17 korrik, policia e Kosovës raportoi se në komunën e Leposaviqit një vozitës kamioni që bartte pije të kontrabanduara bëri ndeshje me automjetin e policisë, duke tentuar që t'i ikë arrestimit. Policia përdori armë zjarri dhe tha që pesë policë ishin lënduar dhe dy automjete të policisë ishin dëmtuar. Familja e vozitësit të arrestuar të kamionit pretendoi se policia kishte ushtruar forcë të tepërt dhe i kishte shkaktuar lëndime trupore atij.

36. Qasja e popullatës lokale në shërbime të caktuara publike raportohet se është ndikuar negativisht pasi që policia e Kosovës mbylli disa rrugë duke hapur gropa me ekskavatorë. Këto rrugë ofronin qasje në vendkalimet jozyrtare në kufirin administrativ në komunat Leposaviq dhe Zubin Potok. Më vonë, policia e Kosovës ka lejuar kalimin e disa individëve nga lista e paraaprovuar, ndërsa pjesë të rrugëve ku gropat ishin hapur me ekskavatorë ishin riparuar për qarkullim të kufizuar të automjeteve.

37. Më 9 qershor, Departamenti i policisë së Kosovës për krime të rënda nxori ftesa për kryetarin e Listës Serbe dhe ministrin për Komunitete dhe Kthime, Goran Rakiq, së bashku me zëvendëskryetarin e partisë dhe deputetin e Listës Serbe në Kuvendin e Kosovës. Ata raportohet se kanë qenë në mesin 72 serbëve të Kosovës që janë akuzuar për “shkelje të rendit kushtetues të Kosovës” në lidhje me protestat në veri të Kosovës gjatë muajve shtator dhe tetor 2021. Këto protesta kanë ndodhur pas vendimeve të Prishtinës për targat e automjeteve dhe pas operacioneve të policës së Kosovës kundër kontrabandës. Lista Serbe deklarojë se çfarëdo arrestimi të personave nga ajo listë do t’i përgjigjemi me protestë dhe me padëgjueshmëri qytetare.

38. Më 5 shtator, kryeministrja në detyrë e Serbisë, Ana Bërnabiq, vizitoi Kosovën veriore, ku u takua me përfaqësuesit e serbëve të Kosovës. Ajo vizitoi qendrën multimediale të Mitrovicës së Veriut dhe vendet fetare të kishës ortodokse serbe, duke përçuar përkushtimin e Serbisë ndaj paqes dhe stabilitetit, si dhe përkrahjen e vazhdueshme për komunitetin serb të Kosovës. Kryeministri Kurti deklarojë se ai shpresonte se vizitat e zyrtarëve nga Serbia në Kosovë do t’i kontribuonin lirisë së lëvizjes në përgjithësi.

## **V. Kthimet, pajtimi, trashëgimia kulturore dhe marrëdhëniet mes komuniteteve**

39. Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR) regjistroi 120 kthime vullnetare të pjesëtareve të komuniteteve joshumicë, të cilët kanë qenë të zhvendosur si brenda Kosovës, ashtu edhe jashtë saj. Nga ky numër i të kthyerve, 65 ishin gra dhe 55 burra (102 serbë, 9 egjiptas, 6 ashkali, 2 romë dhe 1 shqiptar). Kjo e sjell gjithsej numrin e personave të zhvendosur të komuniteteve joshumicë, të cilët kanë gjetur zgjidhje të qëndrueshme në Kosovë që nga viti 2000, në 29185, ku përfshihen 14335 gra dhe 14850 burra (12678 serbë, 7752 ashkali dhe egjiptas, 4049 romë, 1878 boshnjak, 1464 goranë, 1320 shqiptarë, 21 malazez, 19 turq dhe 4 kroatë). Në Kosovë ende mbesin 15683 persona të zhvendosur (7220 gra dhe 8463 burra), si dhe 69627 persona me nevoja të lidhura me zhvendosjen në tërë Ballkanin Perëndimor, nga përafërsisht 200000 persona të zhvendosur nga Kosova që banojnë në regjion, kryesisht në Serbi.

40. Gjatë periudhës raportuese, 328 persona (304 meshkuj dhe 24 femra) kanë parashtruar tek autoritetet kërkesa për azil. UNHCR-ja është siguruar që të gjithë azilkërkuarit të marrin falas ndihmën juridike, përkrahjen psikologjike dhe përkthimin me gojë. UNHCR vazhdoi përkrahjen e komuniteteve ashkallike, egjiptase dhe romë në marrjen e dokumentacionit personal dhe në zgjidhjen e çështjeve të gjendjes civile me qëllim të mundësimin të qasjes së tyre në shërbime publike. Përkrahje shtesë përfshiu lehtësimin e qasjes për të kthyerit dhe personat e zhvendosur në arsim, ndihmë sociale dhe juridike dhe në trajtimin e të drejtave pronësore dhe pensionale.

41. Më 29 mars, UNHCR, UNMIK dhe Ministria për Kthime dhe Komunitete organizuan një seri tryezash të rrumbullakëta në Pejë, Gjilan dhe Lipjan me qëllim të përmirësimit të bashkërendimit në mes të palëve vendore me interes për çështjet lidhur me personat e zhvendosur, procesin e kthimit dhe sfidat e komuniteteve joshumicë. Pjesëmarrësit e tryezave të rrumbullakëta ngritën shqetësime se deprioritetizimi dhe financimi i pamjaftueshëm i komuniteteve dhe i zyrave komunale për kthim pretendohej se i parandalonte nga trajtimi i duhur i nevojave të komuniteteve joshumicë.

42. Më 12 prill, UNMIK-u së bashku me Koordinatorin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim dhe Fondin e Kombeve të Bashkuara për Fëmijë (UNICEF), ishin sponsor të takimit të organizuar nga organizata joqeveritare romë e Kosovës, Kultura Shumetnike e Kosovës, ku u diskutua projektpropozimi i Strategjisë dhe planit të veprimit për integrimin e komuniteteve romë dhe ashkallike të Kosovës për vitet 2022-2026. Qeveria e Kosovës ka miratuar Strategjinë më 22 korrik, ku përfshihet edhe Plani i veprimit 2022-2024 për përcjelljen e zbatimit të saj.

43 Në kuadër të përpjekjeve të institucioneve të Kosovës për avancimin e nismave të bashkëpunimit me komunitete joshumicë, Zyra e Kryeministrit organizoi një konferencë për punësimin shumetnik në institucionet e Kosovës. Kjo Zyrë ka ftuar të gjitha komunat që të aplikojnë për projekte të vogla infrastrukturore dhe ka ndarë fonde për mbështetjen e trajnimeve dhe punësimit të komuniteteve joshumicë të Kosovës.

44. Nuk ka pasur kontribute në fondin e mirëbesimit të Kombeve të Bashkuara në përkrahje të komuniteteve ashkallike, egjiptase dhe rome të prekura nga helmimi me plumb në Kosovë.

45. Nga data 5 deri më 9 korrik, organizata joqeveritare Europa Nostra, e cila është e përkushtuar në ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore në Evropë, ka vizituar Kosovën, e shoqëruar nga përfaqësuesit e Bankës Investive Evropiane. Gjatë kësaj vizite, qeveria e Kosovës kërkoi që Europa Nostra të kërkojë falje për dëmtimin e perceptuar të reputacionit, të shkaktuar nga përfshirja e manastirit të Deçanit në listën e saj të shtatë vendeve më të rrezikuara të trashëgimisë në Evropë. Europa Nostra arsyetoi këtë veprim, duke theksuar në mes të tjerash, sfidat komplekse të sigurisë. Më 20 maj, shtetet e kuintit ritheksuan thirrjen e tyre ndaj qeverisë së Kosovës që të zbatojë pa vonesa të mëtejme vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës të vitit 2016 lidhur me regjistrimin e tokës së manastirit të Deçanit. Më 24 maj, shtetet e kuintit së bashku me Bashkimin Evropian dhe me shefat e tjerë të misioneve diplomatike bënë një vizitë të përbashkët në manastir.

46. Më 21 korrik, Përfaqësuesja Speciale vizitoi Deçanin, ku u takua me udhëheqësit e komunës dhe të manastirit të Deçanit. Ajo diskutoi rreth nismave të ngritjes së besimit mes komuniteteve dhe ruajtjes së trashëgimisë kulturore të manastirit, duke shprehur njëkohësisht përkrahjen e vazhdueshme të UNMIK-ut për dialogun ndërkomunitar dhe ndërtimin e besimit.

47. Më 3 qershor, Dioçeza e Rashkës-Prizrenit dhe e Kosovës e Kishës Ortodokse Serbe pezulloi kontaktet me autoritetet e Kosovës për shkak të shkeljeve të perceptuara të lirive dhe të drejtave themelore fetare. Kjo erdhi pasi që policia e Kosovës ua mohoi qasjen priftërinjve dhe besimtarëve që të mbajnë shërbimin në kishën e papërfunduar të Krishtit shpëtimtarit në Prishtinë, e cila është objekt i kontestit pronësor mes Universitetit të Prishtinës dhe Kishës Ortodokse Serbe. Më 11 qershor, policia e Kosovës, duke cekur mosrespektimin e procedurave zyrtare, gjithashtu refuzoi kërkesën e besimtarëve ortodoksë serbë për të vizituar manastirin lokal në fshatin Mushutishtë të komunës së Suharekës.

## **VI. Sundimi i ligjit dhe të drejtat e njeriut**

48. Gjatë periudhës raportuese, Komisioni i Këshillit të Evropës për Demokraci përmes Ligjit, gjithashtu i quajtur Komisioni i Venedikut, nxori disa opinione lidhur me draftlegjislacionin e Kosovës. Këtu

përfshihej edhe opinioni për propozimamandamentet e ndryshuara në Ligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës, ku thuhet se përbërja e tij e re është në përputhje me standardet ndërkombëtare. Në amandamentet ndryshuara në mes të tjerash sigurohet që prokurorët do të përbëjnë shumicën në krahasim me anëtarët e tjerë të Këshillit, të cilët duhet të zgjedhën nga Kuvendi i Kosovës dhe Institucioni i Avokatit të Popullit i Kosovës, duke zvogëluar kështu rrezikun e politizimit të tij. Kuvendi i Kosovës miratoi propozimamandamentet në qershor. Në të njëjtin muaj, Komisioni i Venedikut nxori opinionet lidhur me Propozimligjin për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificuar, duke shprehur shqetësime për implikimet e mundshme negative të disa dispozitave të tij në të drejta të njeriut, përfshirë këtu mbrojtjen e të dhënave. Ky Propozimligj ka për qëllim futjen e një instrumenti të ri ligjor për “konfiskim civil” të pasurisë së pajustificueshme. Më 14 korrik, Kuvendi miratoi në parim propozimligjin, por janë duke u shqyrtuar amandamente të tjera. Komisioni i Venedikut gjithashtu dha komente lidhur me konceptdokumentin për vetingun e gjyqtarëve dhe prokurorëve, së bashku me amandamentet e ndërlidhura në Kushtetutë. Në mes të tjerash, Komisioni rekomandoi fokusimin në ndryshime legislative që do të ishin më të thjeshta për t’u zbatuar dhe do të kufizonin kontrollet e integritetit të anëtarëve të Këshillit gjyqësor të Kosovës, Këshillit prokurorial të Kosovës, kryetarëve të gjykatave dhe kryeprokurorëve.

49. Më 14 korrik, Kuvendi miratoi Propozimligjet për Kodin e procedurës penale dhe atë për deklarimin e prejardhjes dhe kontrollin e pasurisë e dhuratave. Kodi i procedurës penale parasheh suspendimin e zyrtarëve që kanë akuza për korrupsion, gjykime në mungesë për të gjitha krimet, rregulla më të rrepta për dërgimin e rasteve penale në rigjykim, si dhe procedura të ndryshuara për sekuestrim dhe konfiskim. Kuvendi gjithashtu miratoi Propozimligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale, atë për Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe Propozimligjin për Shërbimin Sprovues të Kosovës që kanë për qëllim përmirësimin e gëzimit të të drejtave nga të burgosurit dhe të ndaluarit, si dhe kushtet e shërbimit për punonjësit.

50 Gjykata e sapothemeluar komerciale ia filloj punës më 1 gusht. Përafërsisht 9000 deri në 10000 lëndë të pazgjidhura janë bartur nga Gjykata themelore e Prishtinës dhe Gjykata e Apelit në jurisdiksonin e Gjykatës Komerciale. Këshilli Gjyqësor i Kosovës filloi rekrutimin e 10 gjyqtarëve për Gjykatë, duke përfshirë 2 nga komuniteti serb.

51. Kohëve të fundit organizatat e shoqërisë civile kanë publikuar disa raporte për sundimin e ligjit. Më 16 mars, OJQ-ja kosovare Lëvizja FOL publikoi raportin për punën e sistemit të drejtësisë në luftimin e korrupsionit në vitin 2021, ku janë identifikuar vonesa të mëdha në marrjen e vendimeve të formës së prerë për rastet relevante gjatë atij viti. Balkan Investigative Reporting Network dhe Internews Kosova gjithashtu kanë publikuar një raport ku janë ngritur shqetësime për cilësinë e dobët të aktgjykimeve të lidhura me korrupsionin dhe

aktakuzat, si dhe ecjen e ngadaltë në trajtimin e rasteve të korrupsionit të profilit të lartë. Në korrik, OJQ-ja Kosovo Law Institute paraqiti raportin e saj për vitin 2021 për rastet e korrupsionit në Kosovë, ku vërehet numër i vogël i dënimeve, moskonfiskimi i efektshëm i pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme dhe mosgatishmëria e gjykatave për shqiptimin e dënimeve plotësuese përveç dënimeve me burg, siç është ndalesa e ushtrimit të funksioneve publike dhe kompensimi i dëmit. Tendenca të ngjashme janë vërejtur edhe në vitin 2022 lidhur me rastet e profilit të lartë të korrupsionit dhe të krimit të organizuar, duke përfshirë vonesat dhe shtyrjet e procedurave penale dhe gjykimeve.

52. Më 29 mars, Zyra e Prokurorisë Speciale e Kosovës shpalli ngritjen e aktakuzës kundër një mashkulli shqiptar të Kosovës me shtetësi të Serbisë. I dyshuari, i cili mbahet në paraburgim që nga marsi 2021, akuzohet për krime të luftës kundër popullatës civile lidhur me masakrën e Izbicës, të datës 28 mars 1999, në fshatin Izbicë të komunës së Skenderajt.

53. Më 29 korrik, në Gjykatën themelore të Prishtinës është mbajtur seanca e parë dëgjimore në rigjykimin e zyrtarit të Listës Serbe dhe ish-ministrit të Administrimit të Pushtetit Lokal, Ivan Todosijeviq. Në dhjetor të vitit 2019 Todosijeviq është dënuar me dy vite burg për “nxitje të urrejtjes kombëtare, racore, fetare apo etnike, ndasive ose jotolerancës” për shkak të mohimit të masakrës së Reçakut të vitit 1999.

54. Sipas Qendrës për të Drejtën Humanitare Kosovë, gjatë gjysmës së parë të vitit 2022, Gjykatat e Kosovës kanë mbajtur procedurat gjyqësore për 14 raste të krimeve të luftës. Shumica e këtyre rasteve presin zgjidhje para gjykatave për vite me radhë. Qendra për të Drejtën Humanitare Kosovë po ashtu ka vërejtur seanca dëgjimore jo të shpeshta dhe vonesa në përkthime të dokumenteve të lëndëve lidhur me rastet e krimeve të luftës, posaçërisht në Gjykatën themelore në Mitrovicë.

55. UNMIK-u vazhdoi përkrahjen e integritit të gjyqësorit dhe të administrimit të drejtësisë në veri të Kosovës, duke u fokusuar në përmirësimin e menaxhimit të lëndëve. Numri i rasteve të pazgjidhura civile në Gjykatën themelore në Mitrovicë ka shënuar rënie pas angazhimit të 10 përkthyesve dhe 4 bashkëpunëtorëve juridikë. Po ashtu, dy gjykatore janë mobiluar dhe pajisur plotësisht në degët e Gjykatës themelore të Mitrovicës në Zubin Potok dhe Leposaviq.

56. UNMIK-u vazhdoi me mbështetjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve në trajtimin e diskriminimit gjinor në institucione me rastin e zbatimit të legjislacionit që ka dispozita për çështjet gjinore. Po ashtu, përkrahu një organizatë joqeveritare në monitorimin e seancave dëgjimore lidhur me pronësinë e përbashkët të pronës, mbajtjen financiare dhe dhunën në familje, si dhe ka organizuar një punëtorë me gjyqtarët e Gjykatës së Apelit lidhur me interpretimin ligjor të dispozitave për pronësinë e përbashkët. Me qëllim të përmirësimit të mbrojtjes së të drejtave të njeriut të të burgosurve dhe të lehtësimit të rehabilitimit të tyre, Misioni furnizoi

me pajisje disa qendra të paraburgimit dhe i ofroi pajisje të teknologjisë informative Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Në përpjekje për plotësimin e boshllëqeve të kapaciteteve bazike të institucioneve për zbatimin e ligjit, UNMIK-u realizoi aktivitete programatike për përmirësimin objekteve të Njësisë së Policisë së Kosovës për Ndërlidhje Ndërkombëtare dhe Bashkërendim në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe protokollet e pandemisë COVID-19, si dhe ka fuqizuar kapacitetet e forensikës digjitale në Agjencinë e Forensikës të Kosovës.

57. Emërimi i kandidatit për pozitën e prokurorit të shtetit të Kosovës nga Këshilli Prokurorial i Kosovës ishte jotransparent sipas Bashkimit Evropian, palëve të tjera ndërkombëtare dhe organizatave të shoqërisë civile. Më 21 prill, Këshilli Prokurorial i Kosovës emëroi ushtruesin e detyrës së prokurorit në pritje të përfundimit të procesit.

58. Disa projektligje lidhur me të drejtat e njeriut ende janë në pritje të miratimit nga qeveria e Kosovës, siç është propozimamandamenti i Ligjit për lirinë e fesë në Kosovë, dhe Projektligji për parandalimin e dhunës në familje dhe mbrojtje nga ajo, për parandalimin e dhunës kundër gruas dhe dhunës në baza gjinore. Më 7 korrik, Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë mbajti një tryezë të rrumbullakët me autoritetet e Kosovës për t'i njoftuar ato për rekomandimet e tij lidhur me zbatimin e Ligjit për mbrojtje nga diskriminimi. Në qershor, qeveria e Kosovës ia paraqiti Raportin e progresit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut (2021–2025) Grupit ndërinstitucional koordinues për të drejta të njeriut. Raporti fokusohet në ndikimin e pandemisë COVID-19 në të drejtat e njeriut në Kosovë.

59. Ministria e Drejtësisë ka finalizuar propozimstrategjinë për drejtësi tranzicionale dhe ia ka dorëzuar kabinetit për miratim. UNMIK-u ka dhënë komentet e veta për propozimstrategjinë, duke theksuar rëndësinë e qasjes përfshirëse të bazuar në të drejta të njeriut dhe me fokus tek viktimat, që do të kishte për qëllim pajtimin dhe mospërsëritjen.

60. Ende janë 1622 persona të zhdukur (263 femra dhe 1359 meshkuj) lidhur me ngjarjet e viteve 1998 dhe 1999 në Kosovë. Përderisa gjatë kësaj periudhe raportuese Grupi punues i Beogradit dhe Prishtinës për personat e pagjetur lidhur me ngjarjet në Kosovë nuk është takuar në nivel të shfave të delegacioneve që nga maji i vitit 2021, janë mbajtur disa takime të nëngrupeve teknike punuese, të cilat kanë pasur përparim të vogël. Në përputhje me marrëveshjen e arritur mes palëve në shtator të vitit 2020, në muajin maj autoritetet e Serbisë bënë vlerësimin e varrezës së mundshme masive në Serbinë jugperëndimore, ku nuk ka pasur raportime për ndonjë gjetje. UNMIK-u ka vazhduar me avokim për rifillimin e takimeve të Grupit punues dhe është angazhuar me familjet e personave të zhdukur nga të gjitha komunitetet për të ndihmuar në avancimin e të drejtës së tyre për të vërtetën.

61. UNMIK-u u angazhua me Institucionin e Avokatit të Popullit në Kosovë, me organizatat joqeveritare, Zyrën e Komisionerit të Lartë të

Kombeve të Bashkuara për të Drejta të Njeriut (OHCHR) dhe me institucionet e tjera për të drejtat e njeriut lidhur me propozimarrëveshjen për transferimin e përafërsisht 300 të burgosurve nga Danimarka në Kosovë me qëllim të sigurimit të përputhshmërisë me standardet ndërkombëtare. Propozimarrëveshja pret miratimin e qeverisë së Kosovës dhe rishikimin nga Kuvendi i Kosovës.

62. UNMIK-u ka vazhduar me përkrahjen e edukimit të të rinjve, profesionistëve ligjorë, autoriteteve komunale dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile për të drejta të njeriut. Misioni ka promovuar të drejtat gjuhësore në Kosovë, duke lehtësuar mësimin e të dyja gjuhëve zyrtare përmes përkrahjes së punës së Komisionerit për gjuhë. Po ashtu ka avokuar për integrimin në kornizën juridike të Kosovës të standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, duke përfshirë ato të Konventës për të Drejtën e Personave me Aftësi të Kufizuara.

63. Në përputhje me Strategjinë kombëtare dhe planin e veprimit për fjalimin e urrejtjes, monitorimi i fjalimeve të urrejtjes dhe i nxitjes së urrejtjes në internet dhe në rrjetet sociale nga UNMIK-u erdhi në përfundim se këto incidente kryesisht ndodhnin përgjatë vijave ndëretnike dhe kanë shënjestruar komunitetin LGBTIQ+. Mungesa e monitorimit sistematik, e mosaprovimit dhe e dënimit të këtyre shkëmbimeve në rrjete sociale nga autoritetet publike rrezikon thellimin e ndasive ndëretnike dhe diskriminimit dhe mund të shkaktojë dhunë.

64. Në shtator, Kuvendi i Kosovës deklaroi se do t'i rishikoj propozimamandamentet e Kodit Civil, të cilat nuk mundin t'i miratojnë më herët gjatë këtij viti pasi që një numër organizatash fetare kundërshtuan përfshirjen e martesës së gjinive të njëjta. Në maj, Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë kërkoi që në propozimamandamente të përcaktohen marrëdhëniet e personave të së njëjtës gjini, duke përfshirë martesat e gjinisë së njëjtë, në përputhje me Kushtetutën e Kosovës.

65. UNMIK-u lehtësoi lëshimin e 18 fletëarresteve ndërkombëtare, 0 njoftime për persona të zhdukur dhe 9 kërkesave për ekstradim nga anëtarët e Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Penale (INTERPOL) në Kosovë. Misioni po ashtu hapi 760 raste për hetim brenda bazës së të dhënave të INTERPOL-it. Gjithsej 667 raste që kanë të bëjnë me territorin apo njerëzit e Kosovës ende mbesin të hapura.

66. UNMIK-u vazhdoi dhënien e shërbimeve të vërtetimit të dokumenteve për përdorim në vende që nuk e njohin Kosovën. Gjatë periudhës raportuese, janë përpunuar gjithsej 2062 dokumente lidhur me pensionet dhe gjendjen civile, siç janë diplomat dhe certifikatat e martesës, të lindjes dhe ato të vdekjes.



## VII. Gratë, paqja dhe siguria

67. Komisioni i Qeverisë së Kosovës përgjegjës për verifikimin dhe njohjen e statusit të të mbijetuarve të dhunës seksuale të lidhur me konfliktin, ka pranuar 1781 aplikacione që nga themelimi i tij në vitin 2018. Që nga shtatori statusi i të mbijetuarve iu është dhënë 1322 aplikantëve (1261 gra dhe 61 burra), nga 1149 në mars 2022. Më 21 prill, Qeveria e Kosovës e vazhdoi mandatin e komisionit verifikues për një periudhë tre vjeçare.

68. Më 8 qershor, UNMIK-u dhe Entiteti i Kombeve të Bashkuara për Barazi Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UN-Women) organizuan Ditën e nëntë globale të hapur të Kombeve të Bashkuara për gratë, paqen dhe sigurinë në Kosovë. Ngjarja u përurua nga Presidentja e Kosovës, Përfaqësuesja Speciale dhe koordinatori i Kombeve të Bashkuara për zhvillim. Më shumë se 120 pjesëmarrës nga institucionet politike dhe të shoqërisë civile të Kosovës diskutuan nevojën e rritjes së pjesëmarrjes së grave në proceset politike dhe ndërtimin e paqes. Nga kjo ngjarje u parashtruan disa rekomandime, si paraqitja e kuotave të pjesëmarrjes për gratë në të gjitha proceset vendimmarrëse, duke përfshirë dialogun e përkrahur nga Bashkimi Evropian, bashkëpunimin me gratë në nivelin bazë për të promovuar ndërtimin e qëndrueshëm të paqes dhe krijimin e mjediseve të sigurt dhe gjithëpërfshirëse për të adresuar ngacmimin institucional kundër grave.

69. Më 4 gusht, UN-Women dhe Bashkimi Evropian përuruan një mural kushtuar viktimave të femicidit për të ndihmuar në rritjen e ndërgjegjësimit për eliminimin e dhunës ndaj grave nëpërmjet artit dhe aktivizmit.

70. Në qershor 2022, me mbështetjen teknike të UN-Women, komunat e Gjakovës, Gjilanit, Prizrenit dhe Mitrovicës Jugore integruan perspektivën gjinore në kornizat e tyre buxhetore afatmesme për të optimizuar buxhetimin për çështje gjinore.

71. Gjatë periudhës raportuese, përdhunimi i supozuar i një vajze 11-vjeçare nga pesë individë në Prishtinë shkaktoi zemërim publik mbi dhunën me bazë gjinore në Kosovë. Organizatat e shoqërisë civile organizuan protesta në Prishtinë, Tiranë dhe Shkup, duke kërkuar krijimin e mekanizmave efektivë për të garantuar drejtësi për viktimat e dhunës seksuale. Misioni iu bashkua deklaratës së Grupit shumëpalësh të sigurisë dhe çështjeve gjinore, i kryesuar nga UN-Women dhe i përbërë nga përfaqësues ndërkombëtarë, qeveritarë dhe të shoqërisë civile, duke bërë thirrje për veprime më të mëdha nga institucionet e Kosovës për të ndihmuar në parandalimin e dhunës me bazë gjinore dhe seksuale.

### VIII. Ndërtimi i besimit, partneriteti dhe bashkëpunimi

72. Misioni ndihmoi në afrimin e komuniteteve, në veçanti të grave dhe të rinjve, përmes fuqizimit ekonomik, artit dhe kulturës dhe dialogut. Gjatë periudhës raportuese, UNMIK-u mbështeti 20 projekte të ndërtimit të besimit për të forcuar marrëdhëniet ndërmjet komunitetit shqiptar, serb, rom, egjiptas, ashkali, boshnjak, turk dhe goran.

73. UNMIK-u vazhdoi të punojë me partnerët lokalë për të avancuar agjendën e tij për ndërtimin e besimit, duke përfshirë edhe promovimin e angazhimit ndër-komunitar përmes Platformës në internet të Kosovës për ndërtimin e besimit, të zhvilluar nga tre organizata joqeveritare shumë-etnike të udhëhequra nga gratë, përkatësisht Open Data Kosovo në Prishtinë, Iniciativa e Re shoqërore dhe Alternativna në veri të Kosovës. Më 18 maj, tri OJQ-të mbledhën më shumë se 100 aktivistë vendorë dhe ndërkombëtarë për të njohur përpjekjet e tyre në avancimin e agjendës së ndërtimit të besimit në Kosovë. Çmimet iu dhanë tri iniciativave: platformës për mësimin e gjuhëve të mbështetur nga UNMIK-u “Voc-Up”, Radios dygjuhëshe shqiptaro-serbe të Forcës së Kosovës dhe iniciativës rinore shumë-etnike Task Forca e Bashkuar Rinore.

74. UNMIK-u avancoi më tej agjendën për të rinjtë, për paqen dhe sigurinë duke mbështetur programet rinore shumë-etnike, duke përforcuar zërat e të rinjve që bëjnë ndryshime dhe duke nxitur ndërtimin e besimit të të rinjve, përfshirë avokimin, kulturën, sportin dhe shkencën. Nga 30 maji deri më 3 qershor, UNMIK-u mbledhi së bashku 150 të rinjë nga Kosova dhe Ballkani Perëndimor për Asambleenë e katërt të Rinisë së OKB-së në Kosovë për të diskutuar sfidat e rinisë, paqes dhe sigurisë në epokën digjitale dhe për të gjetur zgjidhje të përbashkëta. UNMIK-u gjithashtu mbështeti nisjen e programit të parë televiziv të udhëhequr nga të rinjtë, *Heronjtë e rinj-të bashkuar në diversitet*, me një ekip multietnik të të rinjve që bëjnë ndryshime dhe gjejnë zgjidhje kreative për çështje të tilla si ngacmimi në shkollë dhe gjuha e urrejtjes. Programi televiziv u shfaq premierë në lokacione të ndryshme nëpër Kosovë dhe u transmetua në gjuhën shqipe dhe serbe. Në korrik, UNMIK-u bashkëpunoi me rrjetin e astronomëve të rinj me bazë në Kosovë për të restauruar Observatorin e Prishtinës, duke e lansuar atë si një qendër shkencore multietnike për të rinjtë. Observatori, i cili kishte qenë i mbyllur për publikun për më shumë se 35 vjet, u rihap më 13 korrik me mbështetjen e UNMIK-ut dhe Komunës së Prishtinës.

